

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Nehat Qelaj në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. K. nga fshati T. Komuna Malishevës të cilin e përfaqëson av.A. K. nga Malisheva kundër të paditurës K. e M. – D. e A. të cilën e përfaqëson avokati Komunal M. S., lidhur me kompensimin e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, pas shqyrtimit gjyqësor-publik, me datën **19.12.2018** mori këtë:

A K T G J Y K I M
N Ë B A Z Ë T Ë P O H I M I T

I.MIRATOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit E. K. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e M. – D. e A., që në emër të kompensimit të pagave për përcjellje në pension, t'ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej ... euro, me kamat vjetore prej 8% si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej ... euro për një seancë, për padi shumën prej ... euro, në emër të taksave shumën prej ... euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshme.

II. Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit E. K. nga fshati T. sa i përket pagave jubilarë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av.A. K. nga Malisheva në këtë gjykatë ka ngritur padi, me date 17.08.17 kundër të paditurës K.e M.- D. e A. për kompensim të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, duke theksuar nder tjera se paditësi ka punuar prej vitit 2007 në SH. "H.P." në fshatin T. Komuna e Malishevës e në të cilin rast punëdhënës i tij ka qenë d. K. e a. dhe e. në M., me rastin e daljes në pension ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të parapara me ligj mirëpo e paditura nuk e ka përmbushur obligimin ligjor që t'ia paguaj paditësit ... (g.) paga dhe atë ... (t.) paga në emër të pagesës përcjellëse, dhe ... (...) paga në emër të shpërblimit jubilar. E paditura D. në Malishevë ka refuzuar kërkesën duke e njoftuar paditësin me njoftim me shkrim me arsyetim se D. nuk është nënshkruese e kontratës kolektive dhe se nuk ka kurrfarë obligimi për pagesat e ... pagave për shpërblim jubilar, bazuar në këto prova i propozojmë gjykatës që pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave në pajtim me dispozitat ligjore të aprovoj padinë dhe kërkesë padinë si plotësisht të bazuar.

Gjithashtu gjatë seancës gjyqësore i autorizuarit i paditësit këtu av.A. K. ndër të tjera ka deklaruar se: fillimisht në këtë seancë e bëjmë precizimin e padisë dhe kërkesë padisë duke bërë tërheqjen e padis për pagesën për kompensim të shpërblimit jubilar, ashtu që mbesim pranë padis dhe

kërkesëpadi së sa i përket .. pagave pas daljes në pension përkatësisht .. paga neto nga ... euro. Padi tësi tek e paditura ka punuar si punëtor teknik nga viti 2007 deri në vitin 2017 pra ka punuar 10 vite, përvojë pune, andaj në bazë të kontratës kolektive dhe marrëveshjes në mes të qeverisë së Republikës së Kosovës dhe S.-ut padi tësit i takojnë këto paga të lartë përmendura, sa i përket përgjigjes në padi të të paditurës e kundërshtojmë për faktin se në bazë të kësaj marrëveshje dhe kontratës kolektive D. në Malishevë është e obliguar që padi tësit ti paguaj ... paga përcjellëse pas daljes në pension. Ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se: pas administrimit të provave propozon gjykatës që të aprovon në tersi padinë dhe kërkesë padinë e precizuar në këtë seancë pasi që në provat e administruara vërtetohet kërkesëpadija për pagat për shkuarjen në pension e për të cilën i autorizuari i të paditurës nuk e konteston. Shpenzimet i kërkoi dhe specifikoi si në fjalën përfundimtare.

E paditura K. e M. përmes të autorizuarit të saj M. S. fillimisht është pajtuar me tërheqjen e padisë ndaj pagave jubilarë, ndërsa lidhur me pagat me daljen në pension theksoi se K. e M. ka marrë vendim që ti paguhen të gjithë mësimdhënësve me rastin e daljes në pension ... paga me vendim nr. ... të dt. 12.06.2018, por ende nuk është bërë pagesa sipas vendimit pasi që MEF nuk lejon alokimin e këtyre mjeteve pa planifikim buxhetor për këtë vit, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e konteston padinë dhe kërkesëpadinë për ... paga përcjellëse dhe atë sipas aktvendimit të cekur më lartë , pasi që këtë të drejtë padi tësit ja njëhë përmes këtij vendimi, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore dhe mos lejimit nga MEF nuk është bërë ekzekutimi i këtyre pagave pa pasur planifikim buxhetor për këtë vit.

Gjatë seancës përgatitore është konsideruar e tërhequr padia e padi tësit e ushtruar ndaj drejtorisë së arsimit për kompensim të pagave të shpërblimit jubilarë në pension

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata me propozimin dhe pëlqimin e palëve pas përfundimit të seancës përgatitore menjëherë hapi shqyrtimin kryesor duke bërë administrimin e provave dhe atë: Aktvendimi për ndërprerjen e punës nr.... i dt.03.07.2017, kontrata e punës nr.... dt.01.10.2015, pasqyra bankare e padi tësit dt.17.08.2017 N., vendimin e Asamblesë komunale ... dt.12.06.2018,njoftimi i Komunës Malishevës nr.... dt.02.08.2017.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat e nenit 7 e 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestuese fakti se E. K. kishte punuar si mësimdhënës në SH. “ H. P.” për 10 vite përkatësisht tek e paditura dhe ka dale në pension në gusht 2017 pasi që i ka plotësuar kushtet e parapara ligjore dhe se paga e tij e fundit ishte ... euro.

Andaj meqenëse edhe nga i autorizuari i paditurës nuk u kontestua kërkesë padia për ... pagave pas pensionimit për cilin edhe Asambleja Komunale kishte marr vendimi nr.... për pagesën e këtyre pagave për personelin arsimor dhe shëndetësor, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm mori aktgjykim në bazë të pohimit duke u bazuar edhe në nenin 148 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata me rastin e vendosjes nuk gjeti rrethana me të cilat do të konstatohej se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht sipas nenit 3 paragrafi 3 të LPK-së, andaj bazuar edhe në të lartcekurat vendosi ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe për këtë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160 paragrafi 6 të LPK-së, Gjykata ka dhënë vetëm arsyet e marrjes së këtij Aktgjykimi, ndërsa Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452 të LPK-së.

Vendim për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452.1 lidhur me 453 të Ligjit për Procedurës Kontestimore sipas së cilës paditëses i pranohen shpenzimet në emër të përfaqësimit nga avokati vetëm për një seancë shumë prej ... euro si dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej ... euro, si dhe për padi shuma prej ... euro.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.286/17 e datës 19.12.2018

GJYQTARI
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.